

Master shkencor në Mësuesi (AML) në Gjuhë Gjermane

Programet e lëndëve

Viti I

Semestri I

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES DHE TË MENDUARIT KRITIK

Titullari / pedagogu i lëndës: Prof. dr. Bardhyl Musai

Ngarkesa: 7 kredite; 90 orë mësimore; 60 leksione / 30 seminare

Tipologjia e lëndës: A-Lëndë bazë (Përgatitje metodologjike)

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti 2021-2022/ Semestri i parë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
bardhyl.musai@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Metodologjia e Mësimdhënies dhe të menduarit kritik është shqyrtimi dhe studimi i praktikave më të përdorshme dhe të përshtatshme sot në procesin e të nxënit mësimdhënies në të gjitha nivelet dhe llojet e shkollimit, i klasifikimit të karakteristikave të çdo modeli, natyrës, evoluimit dhe zhvillimit të secilit prej tyre, përmes metodave të të nxënit aktiv, aspekteve psikologjike të zbatuara në mësimdhënie.

Mësimdhënia dhe të të menduarit kritik do të ndihmojë studentët në një perceptim më të qartë mbi detyrën e tyre në lehtësimin e të nxënit të secilit prej nxënësve në klasë. Këto perspektiva teorike për vite me radhë kanë influencuar konceptimin, hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve, shërbimeve dhe politikave arsimore. Lënda ka karakter modular.

Shqyrtimi dhe studimi i praktikave më të përdorshme dhe të përshtatshme sot në procesin e mësimdhënies në të gjitha nivelet dhe llojet e shkollimit, i klasifikimit të karakteristikave të çdo modeli, natyrës, evoluimit dhe zhvillimit të secilit prej tyre, shqyrtimin e aspekteve të metodave të mësimdhënies, të menduarit kritik përmes metodave të të nxënit aktiv, aspekteve psikologjike të zbatuara në mësimdhënie dhe aftësimi i studentëve më pas për të zhvilluar kurrikulën dhe të planifikojnë

mësimin.

Të menduarit kritik i kushton vëmendje të konsiderueshme procesit të induksionit për të dalë me shpjegimin më të mirë, sepse ky është ndoshta lloji i induksionit që përdorin më shumë studentët, dhe shërben si bazë për shqyrtimin e pretendimeve dhe teorive, por edhe si një metodë për të testuar vlerën e tyre.

Moduli për të menduarit kritik përmban arsyetimin induktiv dhe argumentimin shkakësor, teoritë shkencore dhe metodën për të arritur në shpjegimin më të mirë si dhe metodën shkencore në vlerësimin e teorive.

Një nga strategjitë që ndjek ky modul është t'u shërbejë studentëve të zbatojnë parimet e të menduarit kritik në një spektër të gjerë disiplinash dhe lëndësh si dhe në vijimësi të këtij procesi, t'u tregojë atyre se aftësi të tilla gjejnë përdorim të gjerë në jetën e tyre dhe se janë të dobishme në një shumëllojshmëri rrethanash të veprimitarisë së përditshme.

Vendosja e theksit të vlerësimi i fakteve, kompetenca dhe besueshmëria u tregon studentëve se si vlerësohen pretendimet dhe provat që ofrojnë ekspertët, shkenca, mediat dhe përvoja personale.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Në përfundim të lëndës, studentët:

- Dallojnë metodat më kryesore të mësimdhënies.
- Klasifikojnë karakteristikat kryesore të metodave të mësimdhënies.
- Evidentojnë rezultatet e studimeve sipas përvojave të ndryshme.
- Zbatojnë modelet moderne të mësimdhënies në sistemin tonë arsimor.
- Gjykojnë në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese.
- Kuptojnë përkufizimin e të *menduarit kritik*, rëndësia dhe përkufizimi i termave 'sistematik', 'vlerësim', 'formulim' dhe 'kritere racionale'.
- Kuptojnë se si lidhet të menduarit kritik me logjikën, vërtetësinë apo pavërtetësinë e thënieve, dijet dhe fuqizimin personal.
- Krijojnë vetëdijen se ekzistojnë metoda (1) për të kapur gabimet në mënyrën tonë të të menduarit, (2) për të kontrolluar qëndrimet dhe ndjenjat që mund të shtrembërojnë arsyetimin tonë dhe (3) për të arritur një nivel objektiviteti, i cili mundëson të menduarit në mënyrë kritike.
- Tregojnë se pengesat më të zakonshme ndaj të menduarit kritik mund të grupohen në dy kategori: (1) pengesa që kanë shkak *mënyrën* se si mendojmë dhe (2) pengesa që kanë shkak *atë* që mendojmë.
- Kuptojnë se kur një pretendim përplasit me pretendime të tjera, të cilat ne kemi arsye të mjaftueshme për t'i pranuar, atëherë kemi arsye të forta për ta

vënë atë në dyshim.

- Dallojnë se kur një pretendim vjen në kundërshtim me njohuritë tona themelore, kemi arsye të mjaftueshme për ta vënë në dyshim atë.

Objektivat specifike lëndore:

Në përfundim të studimit të lëndës studentët do të jenë të aftë:

- Të dallojnë metodat më kryesore të mësimdhënies
- Të analizojnë karakteristikat kryesore të metodave të mësimdhënies
- Të evidentojnë rezultatet e studimeve sipas përvojave të ndryshme
- Të zbatojnë modelet moderne të mësimdhënies në sistemin tonë arsimor
- Të gjykojnë në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese
- Të fitojnë shprehitë kryesore të të menduarit kritik
- Të dallojnë parimet e të nxënimit aktiv dhe të menduarit kritik
- Të zotërojnë metodat e mësimdhënies për të menduarit kritik
- Të planifikojnë strategji të përshtatshme të mësimdhënies.

PSIKOLOGJI ZHVILLIMI

Titullari i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Arjana Mucaj
Ngarkesa:	4 kredite 1 semester, Viti I, Semestri I(30 leksione / 15 seminare,60 orë total)
Tipologjia e lëndës:	Formimi i specializuar
Viti Akademik:	2021-2022, 1 semestër, Viti I, semestri I
Lloji i lëndës:	E detyrueshme
Programi i studimit:	Master shkencor me drejtim mësuesi
Kodi i lëndës:	A
Adresa elektronike e pedagogut/	
Titullarit të lëndës:	Departamenti Pedagogji-Psikologji, FSHS

Përmbledhja e lëndës, qëllimet dhe rezultatet e të nxënit

Psikologji Zhvillimi, “Zhvillimi i moshës shkollore” është një lëndë, që zhvillohet me studentët e ciklit të dytë të studimeve, në degën e mësuesisë.

Nëpërmjet tij, studentët marrin njohuri të zgjeruara për zhvillim e moshës shkollore si proces shumë i rëndësishëm në formimin dhe edukimin e nxënësit. Pra ata mësojnë se si rritja dhe zhvillimi ndikojnë mbi personalitetin, mbi mënyrën e të menduarit dhe sjelljes.

Zhvillimi fizik, kognitiv, psikosocial i nxënësit zë një vend shumë të rëndësishëm në synimet dhe objektivat mësimore të këtij kursi.

Përgatitja e mësuesit për një njohje qoftë në aspektin fizik, kognitiv psikosocial të nxënësit do ti ndihmonte, orientonte në punën e tyre gjatë zhvillimit të mësimin për të arritur rezultate efektive që i shërbejnë pikërisht procesit mësimor.

Gjatë këtij kursi studenti nuk do të mjaftohet vetëm me marrjen e njohurive teorike mbi zhvillimin e teorive që njihen në psikologjinë e zhvillimit, por seminarët, trajtesat, detyrat e kursit, ilustrimet e ndryshme do t’u vijnë në ndihmë në këtë drejtim.

Qëllimet e lëndës

Qëllimi i këtij kursi është të ndihmojë studentin për të njohur teorinë e zhvillimit moshor shkollore, të kuptojnë logjikën dhe zbatimin e tyre dhe të arrijnë të bëjnë evidentimin e tyre në zhvillim, në sjellje apo demonstrime të ndryshme gjatë performancës së nxënësit.

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të studimit të lëndës studenti do të jetë i aftë:

1. Të japë një përcaktim të saktë mbi kuptimin e zhvillimit njerëzor.
2. Të shpjegojë përmbajtjen thelbësore të disa prej teorive kryesore të zhvillimit njerëzor (bihejviorizmit, konjektivizmit, psiko-social) dhe të teorive të tjera që lidhen me to.
3. Të përmendë faktorët (fizik, kognitiv, psikologjik, social) dhe të argumentojë ndikimin e tyre tek zhvillimi njerëzor.
4. Të përshruajë ndryshimet që ndodhin gjatë zhvillimit fizik, kognitiv dhe emocional

në moshën parashollore e të fëmijërisë së mesme .

5. Të përshkruajë zhvillimin psikosocial në fëmijëri.

6. Të skicojë zhvillimin fizik në adoleshencë.

7. Të njohë problemet themelore të personalitetit dhe të zhvillimit social në adoleshencë.

8. Të identifikojë faktorët psikosocialë që çojnë në përfshirjen e adoleshentëve në situata të rrezikshme për to.

9. Të njohë konceptet e paraqitura në secilën nga teoritë e përmendura

Psikologji edukimi

Titullari /pedagogu i lëndës: Prof. dr. Bardhyl Musai

Ngarkesa: 4 Kredite (30 leksion, 15 seminar, 90 punë e pavarur)

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti i parë, semestri i parë

Lloji i lëndës: e detyrueshme

Programi i studimit: M.Sc. Mësuesi në Gjuhët e Huaja

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: bardhyl.musai@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Përmbledhje

Qëllimi i këtij kursi është të ofrohen koncepte dhe praktika bazë nga psikologjia e edukimit që u mundëson studentëve-mësues të ardhshëm të japin mësim për zhvillimin e gjithanshëm intelektual të nxënësve për shprehitë e të menduarit, të zgjidhjes së problemeve, mendimit kritik dhe të zhvillimit të reflektimit dhe vetë-rregullimit në të gjitha fushat e të nxënësve. Kjo lëndë paraqet interes për të gjithë ata që janë të përfshirë në mësimdhënie dhe në edukimin e brezave. Për të zotëruar përmbajtjen e këtij kursi nuk kërkohen njohuri paraprake në fushën e psikologjisë apo të edukimit. Kursi arrin të tregojë se si informacioni dhe idetë e nxjerra nga studimet në fushën e psikologjisë së edukimit vihen në praktikë për të zgjidhur problemet e procesit mësimor. Për të ndihmuar studentët të kuptojnë lidhjen midis praktikës dhe teorisë, ata do të ndeshin në veprimtaritë e këtij kursi një mori shembujsh, mësimesh, rastesh studimore, udhëzimesh, madje edhe këshilla praktike nga mësues me përvojë.

Objektivat e përgjithshme lëndore

Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje:

- Të zotërojnë njohuri dhe shprehi për zhvillimin kognitiv, gjuhësor, personal, social dhe moral.
- Të zotërojnë njohuri për të nxënët bihejviorist dhe kognitiv.
- Të zotërojnë njohuri për teoritë dhe praktikatat e ndryshme të të nxënët.
- Të vlerësojnë mbi bazën e shprehive të të menduarit kritik dhe të strategjisë të zgjidhjes së problemeve.
- Të ndërtojnë dije dhe shprehi për të mësuar çdo nxënës, në çfarëdo kushtesh e rrethanash.
- Të zotërojnë shprehitë e vlerësimit objektiv të nxënësve.

Objektivat specifike lëndore

Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje:

- Të formulojnë argumente pro dhe kundër për një aspekt lëndor.
- Të zotërojnë shprehi praktike në interpretimin e të nxënët të të gjitha llojeve.
- Të identifikojnë probleme me karakter psikologjik në procesin e të nxënët.
- Të vlerësojnë suksesin në mësimdhënie bazuar në trajtimin psikologjik të rasteve.

Psikolinguistike

Titullari / pedagogu i lëndës: Mihallaq Zilexhiu Dr.

Ngarkesa: 4.. kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022 Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
mihallaq.zilexhiu@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNËT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë:

- Të arrijë të zhvillojë kompetencën e arsytimit, argumentimit dhe sistemimit të njohurive përmes sistemimit të njohurive , përzgjedhjes së materialeve, pjesëmarrjes në diskutime dhe paraqitjes së projekteve të ndryshe gjatë mësimit përpara kursit.

- Të arrijë të marrë njohuri mbi psikolinguistikën dhe lidhjen e saj me mësimin e gjuhëve të huaja.
- Të mësojë të ushtrojë një mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ në interpretimin e materialeve të ndryshme.
- Të përzgjedhë dhe t'i referohet një bibliografije shkencore të mirëfilltë
- Të ndër marrë studime të mëtejshme në kuadër të punimeve të ndryshme shkencore.

Objektivat specifike lëndore:

- Të shtrojë dhe komunikojë me gojë dhe shkrim problemet teorike që lidhen me psikologjinë në fushë të linguistiknë përgjithësi
- Të formulojë dhe argumentojë mendimet e tij si dhe të nxjerrë përfundimet përkatëse
- të argumentojë ndikimin e psikologjisë në mësimin e gjuhës amtare dhe asaj të huaj
- të provojë ndikimin e gjuhës amtare në kuptimin e gjuhës së huaj të dëgjuar dhe të lexuar
- të provojë ndikimin e faktorëve psikologjikë afektivë e konjitivë në mësimin e gjuhës së huaj
- të provojë ndikimin e faktorit moshë në mësimin e gjuhës së huaj.

GJUHË E HUAJ C (1)

Titullari /pedagogu i lëndës: Evis Vasili

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë seminar

Tipologjia e lëndës: D

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022, viti i parë, semestri i parë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike: evivasili@gmail.com

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të kalojë nga një nivel më i ulët në nivelin pasardhës më të lartë në zotërimin e gjuhës gjermane. Studentët duhet të aftësohen në shprehinë e të folurit, të shkruarit, të lexuarit dhe dëgjuarit në gjuhën gjermane. Lënda synon zotërimin praktik të gjuhës së shkruar gjermane, pajisjen e studentëve me aftësitë dhe shprehitë komunikative bazë (leximi, dëgjim, të folur, shkrim) brenda disa tematikave të njohura dhe mbi bazën e materialit leksiko-gramatikor të përvetësuar. Studenti duhet të jetë i aftë të:

- Të zgjerojë leksikun
- Të perfeksionojë njohuritë gramatikore dhe ti zotërojë rregullat gramatikore në praktikë gjatë të folurit
- Të përmirësojë aftësinë e të kuptuarit të teksteve të folura, pra të rrisë aftësinë dëgjimore-kuptimore dhe ti praktikojë ato me anë të të folurit.
- Të përmirësojë aftësinë e të shprehurit me gojë, aftësinë e argumentimit.

Objektivat specifike lëndore:

Kjo është një lëndë e detyrueshme në kurrikulën e degës së Gjuhës Angleze dhe Franceze, e cila zhvillohet në semestrin e parë të vitit të parë me 60 orë seminare. Lënda ka karakter praktik (me shpjegimet respektive teorike të titullarit) dhe u shërben studentëve për të përmirësuar aftësitë dhe kompetencat e tyre gjuhësore në aspektin praktik në të katërta shprehitë në bazë të nivelit me të cilin ata hyjnë në vitin e parë. Në përfundim të secilit modul, studenti duhet të ketë kapërcyer një nivel (B2).

Viti I

Semestri II

Te nxenet dhe menaxhimi i klases

TITULLI I LËNDËS:	Të nxënit dhe menaxhimi i klasës
LLOJI I LËNDËS:	E formimit të specializuar
KREDITET:	6
KOHA E REALIZIMIT:	1 semester, Viti I, Semestri I(3L,1S,60 orë në total)
Pedagogu i lendes:	Prof. Dr. Theodhori Karaj

MODULI I TË NXËNIT:

Njohja me teoritë më të vlefshme të të nxënit përsa i përket rëndësisë së tyre aplikative në sistemet arsimore botërore do të ndihmojë studentët në një perceptim më të qartë mbi detyrën e tyre në lehtësimin e të nxënit të secilit prej nxënësve në klasë. Këto perspektiva teorike për vite me radhë kanë influencuar konceptimin, hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve, shërbimeve dhe politikave arsimore.

QËLLIMI I MODULIT:

Ky kurs do të ndihmojë studentët të identifikojnë, të dallojnë mes teorive të të nxënit dhe t'i aplikojnë ato. Kjo do të përmirësojë aftësitë e tyre në lehtësimin e të mësuarit të nxënësve, duke krahasuar dhe vënë në provë besimet e tyre personale mbi mënyrën më të mirë për të mësuar; duke përdorur aktivitete të nxëni autentike, të bazuara në kontekst; duke vënë në pyetje dhe duke reflektuar mbi mënyrën e tyre të të nxënit për të kuptuar larmishmërinë e mënyrave si mësojmë.

MODULI: MENAXHIMI I KLASËS

Synimi i kësaj lënde është që të pajisë studentët e degëve të mësuesisë me procedurat e menaxhimit të sjelljes së nxënësve si individ dhe si grup, si dhe me procedurat e mësimit që mund të përdoren në situata të ndryshme në klasë. Lënda përmban koncepte teorike si dhe strategji të zbatimit konkret që synojnë të krijojnë mjedise të të mësuarit të sigurt, inkurajuese dhe efektive. Bazuar në eksperiencën theksi do të vihet në përdorimin e : (a) procedurave të mësimit dhe jo në përmbajtjen e mësimit (b) në vlerësimin e sjelljes dhe të programeve dhe (c) në principet themelore të menaxhimit të klasës.

Qëllimet e lëndës

Lënda “Menaxhimi i klasës”, ka për qëllim:

- Të pajisë studentët me metodat e menaxhimit të klasës dhe parandalimit të sjelljeve problematike.
- Të pajisë studentët me dijet dhe metodat specifike për analizimin dhe trajtimin e sjelljeve problematike të nxënësve

ZHVILLIMI I KURRIKULËS

Titullari / pedagogu i lëndës: Doc.Dr. Mimoza Çarka

Ngarkesa: kredite 4; 45 orë mësimore; 30 leksione / 15 seminare

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti 2021-2022 / Semestri i parë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
mimoza.carka@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Përmbajtja e lëndës i pajis studentët me elementët më të rëndësishëm të formimit të mësuesve mbi kurrikulën në përgjithësi dhe kurrikulën me bazë kompetencat. Studentët marrin njohuri rreth zhvillimit të kurrikulës, parimeve, bazave, strukturës dhe tendencave të zhvillimit të saj. Studentët njihen me tema të cilat bëjnë të mundur vlerësimin e kurrikulave dhe të procesit të të mësuarit si dhe trajtimin e bazave të matjes, të vlerësimit në arsim.

Programi i kësaj lënde i aftëson studentët me konceptet që kanë lidhje me bazat psikologjike dhe historike të kurrikulës. Për më tej me modelet përfaqësuese të kurrikulës, burimet, qëllimet, synimet dhe objektivat. Nëpërmjet kësaj lënde hidhet dritë mbi aspektet themelore të kurrikulës, si dhe elementët e kurrikulës.

Në vazhdimësi paraqiten hapat për planifikimin e matjes dhe të vlerësimit. Ky program sjell pranë studentëve kurrikulat shkollore më të përshtatshme, më të vlerësuar si kurrrikula bashkëkohore si dhe zbatimin e suksesshëm të tyre në botë. Një vend të veçantë zë korniza kurrrikulare në Republikën e Shqipërisë në Arsimin Parauniversitar dhe në detaje Kurrikula Bërthamë e Arsimit Parashkollor dhe Arsimit Fillor.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Programi i kësaj lënde i aftëson studentët të kuptojnë në mënyrë vizionare bazat, parimet e ndërtimit të kurrikulës, hartimit të saj nga këndvështrimi psikologjik dhe historik.
- Programi i kësaj lënde i aftëson studentët me konceptet që kanë lidhje me bazat psikologjike dhe historike të kurrikulës.

- NËPËRMJET KËSAJ LËNDE HIDHET DRIË MBI ASPEKTET THEMELORE TË KURRIKULËS, SI DHE ELEMENTËT E KURRIKULËS.
- Tu japë mundësi studentëve të thellojnë kuptimin e tyre mbi kurrikulën shkollore shqiptare, duke u fokusuar në punën studimore.
- Studentët do të kenë mundësi të njihen me çështjet kryesore teorike mbi kurrikulën dhe do të zhvillojnë strategji për të vlerësuar kurrikulën shkollore, sidomos çështjet që duhet të përballin nxënësit dhe mësuesit kur duhet të punojnë me të.

Vlerësimi i Nxenesit

Titullari / pedagogu i lëndës: Prof. Dr. Nikoleta Mita

Ngarkesa: 5 kredite; 60 orë mësimore; 45 orë leksione/ 15 orë seminare

Tipologjia e lëndës: B- E formimit karakterizues

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti 2021-2022/ Semestri i dytë

Lloji i lëndës: E detyrueshme

Programi i studimit: Master i shkencave në Mësuesi, Gjuha gjermane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

nikoleta.mita@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJA E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Lënda është e destinuar për studimet Master i Shkencave në Mësuesi. Lënda ka si qëllim t'u zhvillojë studentëve që po përgatiten për mësues, kompetencat për të përdorur vlerësimin në kontekstin e klasës. Lënda është e organizuar në tri pjesë. Në pjesën e parë përfshihen tema të cilat trajtojnë bazat e matjes dhe të vlerësimit në arsim. Objekt i pjesës së dytë janë bërë temat për instrumentet e matjes për vlerësimin e nxënësit. Nga shumëllojshmëria e instrumenteve të matjes janë veçuar testet objektive dhe subjektive, testet e standardizuara, testet e përgatitura nga mësuesi, mjetet dhe procedurat e vrojtimit të përditshëm. Pjesa e tretë i kushtohet praktikave të realizimit të matjes dhe të vlerësimit të nxënësit. Në këtë pjesë janë përfshirë çështjet kryesore që lidhen me politikën e vlerësimit të nxënësit, me sistemet e vlerësimit, të praktikave të përdorimit të notave,

me vlerësimin e punimeve të nxënësve, me interpretimin dhe raportimin e të dhënave të matjes dhe të vlerësimit.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Nëpërmjet studimit të lëndës do të:

- zhvillohet njohja dhe të kuptuarit për vlerësimin dhe rolin e mësuesit si vlerësues;
- zhvillohen aftësitë për analizën, sintezën, vlerësimin;
- zhvillohen aftësitë për të zbatuar dijen në situata praktike;
- zhvillohen aftësitë për të planifikuar dhe menaxhuar procesin e vlerësimit të nxënësit
- zhvillohen aftësitë për të zgjidhur problemet e vlerësimit;
- zhvillohen aftësitë për t'i komunikuar vlerësimet audiencave të ndryshme të interesuara për vlerësimin e nxënësit;
- zhvillohen aftësitë për të analizuar dhe interpretuar informacionin e vlerësimit nga burime të ndryshme;
- zhvillohen aftësitë për të bërë kritikë profesioanle dhe për të reflektuar;
- zhvillohen aftësitë për të marrë vendime të bazuara në kritere profesionale dhe etike.

Metodat e mësimdhënies së gjuhës së huaj B

Titullari : Kadzadej, Brikena, Prof.dr.

Ngarkesa: Kredite 6, 40 leksione- 20 seminare

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: 2021-2022

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9).

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës: brikena.kadzadej@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Metodologjia e mësimit të gjuhës së huaj është lëndë formuese bazë e Masterit “Mësuesi”. Kjo lëndë jep njohuri të gjera didaktike dhe metodike, si edhe shprehitë për transmetimin e gjermanishtes si gjuhë e huaj dhe për krijimin e shprehive dhe aftësive gjuhësore në grupet heterogjene të atyre që nxënë.

Objektivat specifikë lëndorë: Ky kurs ka si objektiv trajtimin në vija të përgjithshme teorike të çështjeve. Ai paraqet se si mund të reagohet nga ana metodike për problemet e identifikuara nga teoria didaktike gjatë planifikimit dhe organizimit të mësimit.

Gjuhësi e zbatuar

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Ergys Prifti

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare

Tipologjia e lëndës: C

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022 / Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: ergys.prifti@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Programi përmban trajtimin e temave që lidhen me metodologjinë e kërkimit në gjuhësinë e aplikuar dhe veçanërisht të kërkimit në gjuhën gjermane, konceptualizimi dhe realizimi i kërkimit, parashtrimi i çështjeve të kërkimit, metodat dhe teknikat e kërkimit, mënyrat e mbledhjes, përpunimi dhe analizimi i të dhënave, shkrimi i raporteve të kërkimit dhe raportimi i rezultateve të kërkimit.

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë të njohin teorikisht dhe praktikisht fushat kryesore të gjuhësisë së aplikuar, dhe të jenë në gjendje të praktikojnë me sukses këto njohuri në orën e mësimit të gjuhës gjermane.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të arrijë të marrë njohuritë bazë të gjuhësisë së aplikuar
- Të njohë teknikat e nevojshme për studimin e tematikës së lëndës
- Të mësojë të kërkojë dhe të organizojë e sistemojë informacionin gjuhësor të lëndës

Objektivat specifike lëndore:

- Të mësojë të planifikojë punën sipas etapave të caktuara
- Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.
- Të analizojë rastet e paraqitura
- Të punojë në mënyrë të pavarur me fjalorë dhe leksikonë një- dhe dygjuhësh
- Të dokumentojë punën e kryer
- Të referojë e të bëjë të njohur rezultatet e kërkimit të tij.

KOMUNIKIM NDËRKULTUROR

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Marisa Janku

Ngarkesa: 4 kredite, 30 orë leksione, 10 orë seminar

Tipologjia e lëndës: C

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022, viti i parë, semestri i dytë, Cikli II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike: marisa.janku@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të ketë njohuri paraprake të teorisë së komunikimit dhe aspekteve kulturore të vendeve gjermanishtfolëse. Kjo është një lëndë me detyrim dhe me karakter formues gjuhësor që synon rritjen e kompetencës ndërkulturore në gjuhën B si dhe rritjen e aftësisë së studentëve për punë të pavarur në përballje me të huajën në situata të ndryshme ndërkulturore.

Kompetenca të përgjithshme:

Aftësia për të zhvilluar kompetencën e përgjithshme komunikuese në gjuhën B dhe asaj ndërkulturore për të komunikuar në mënyrë sa më efektive me njerëzit e kulturave të ndryshme.

Aftësia për të zhvilluar mendimin analitik, kritik, logjik nëpërmjet përballjes me situata të ndryshme ndërkulturore gjatë procesit të komunikimit në gjuhën B.

Publiku i synuar: studentët në Master, drejtimi mesuesi

Objektivat specifike lëndore:

Kjo është një lëndë e detyrueshme në kurrikulën e degës së Gjuhës gjermane Master shkencor në Mësuesi, e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të parë me 30 orë leksione dhe 10 orë seminare. Lenda ka karakter teorik dhe praktik (me shpjegimet respektive teorike të titullarit) dhe u shërben studentëve të trajtojnë dy nocione komplekse, siç janë kultura dhe komunikimi, si dhe arritja e të kuptuarit midis përfaqësuesve të kulturave të ndryshme, në mënyrë që studentët të dinë të sillen dhe të komunikojnë efektivisht në vendet gjermanishtfolëse, gjatë takimeve të ndryshme ndërkulturore.

GJUHË E HUAJ C (2)

(Formati sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL)

Titullari /pedagogu i lëndës: Ma. Evis Vasili

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë seminar,

Tipologjia e lëndës: D

Viti akademik: 2021-2022 viti i parë, semestri i dytë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike: evivasili@gmail.com

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të kalojë nga një nivel më i ulët në nivelin pasardhës më të lartë në zotërimin e gjuhës gjermane. Studentët duhet të aftësohen në shprehinë e të folurit, të shkruarit, të lexuarit dhe dëgjuarit në gjuhën gjermane. Lënda synon zotërimin praktik të gjuhës së shkruar gjermane, pajisjen e studentëve me aftësitë dhe shprehitë komunikative bazë (leximi, dëgjim, të folur, shkrim)

brenda disa tematikave të njohura dhe mbi bazën e materialit leksiko-gramatikor të përvetësuar. Studenti duhet të jetë i aftë të:

- Të zgjerojë leksikun
- Të perfeksionojë njohuritë gramatikore dhe ti zotërojë rregullat gramatikore në praktikë gjatë të folurit
- Të përmirësojë aftësinë e të kuptuarit të teksteve të folura, pra të rrisë aftësinë dëgjimore-kuptimore dhe ti praktikojë ato me anë të të folurit.
- Të përmirësojë aftësinë e të shprehurit me gojë, aftësinë e argumentimit.

Objektivat specifike lëndore:

Kjo është një lëndë e detyrueshme në kurrikulën e degës së Gjuhës Angleze dhe Franceze, e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të parë me 60 orë seminare. Lënda ka karakter praktik (me shpjegimet respektive teorike të titullarit) dhe u shërben studentëve për të përmirësuar aftësitë dhe kompetencat e tyre gjuhësore në aspektin praktik në të katërta shprehitë në bazë të nivelit me të cilin ata hyjnë në vitin e parë. Në përfundim të secilit modul, studenti duhet të ketë kapërcyer një nivel (B2).

Viti II

Semestri I

TIK NË MËSIMIN E GJUHËS SË HUAJ

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Migena Sejdini

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; TIK në mësimin e gjuhës së huaj (30/30);

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në “Mësuesi për gjuhën gjermane”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

migena.sejdini@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të japë një panoramë të përgjithshme të punës praktike me materiale mësimore, media dhe teknologji të ndryshme në mësimdhënien e gjuhës gjermane. Njohja me këto materiale, media analoge dhe në veçanti mediat dixhitale, si mjete të reja mësimore të gjuhës së huaj, por edhe hartimi dhe përzgjedhja e tipologjisë së ushtrimeve dhe materialeve në përshtatje me median e përzgjedhur, si dhe didaktizimi i tyre do të jetë qendër të këtij kursi.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar llojet e materialeve dhe medieve që përdoren në mësimdhënien e gjuhës së huaj. Do të analizohen metodat aktuale të mëimit të gjuhës gjermane, komponentët e tyre, mënyra si janë ndërtuar, materialet shitesë që janë përgatitur për to nga shtëpitë botuese. Studentet do të njihen me kriteret që përdoren për analizimin e këtyre metodave. Gjithashtu ata do të njihen edhe me llojet e ndryshme të teksteve, përzgjedhjes së tyre, përshtatjes dhe didaktizimit sipas nivelit gjuhësor të grupit të synuar. Gjithashtu në këtë kurs do të identifikohen dhe analizohen tipologjitë e ushtrimeve që përdoren për secilën nga shprehjet gjuhësore. Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe rolit që luajnë mediat dixhitale në mësimin e gjuhës gjermane. Në këtë kuadër ky kurs do të identifikojë dhe prezantojë mediat dixhitale dhe koncepte në kontekstin e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj. Përmes shembujve konkretë studentët do të aftësohen veç të tjerash edhe në planifikimin dhe zhvillimin e orëve mësimore duke përdorur mediat dixhitale në orën e mëimit, me qëllim rritjen e efikasitetit të nxënies gjatë këtyre orëve.

Gjuhë e huaj për qëllime specifike

Titullari / pedagogu i lëndës: Mihallaq Zilexhiu, Pedagog Dr.

Ngarkesa: 6 kredite, 30 leksione + 30 seminare

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik / 2021-2022 semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në gjuhën gjermane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës:

mihallaq.zilexhiu@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs do të krijojë mundësi që studenti të njohë dhe dallojë vendin e gjuhëve specifike në raport me gjuhën standarte të përdorimit në komunikimin e përditshëm pa ngjyresat specifike të lidhura me fushat e përdorimit specifike të saj. Ai do të krijojë një ndërgjegjësim mbi të veçantat që e bëjnë gjuhën për qellime specifike të ndryshme nga gjuha e përditshmërisë. Përdorimi i këtyre njohurive në praktikë është thelbësore për studentin në rolin e tij si mësues me nxënës dhe persona që mësojnë gjuhën për ta praktikuar atë në fusha të ndryshme të profesioneve të tyre.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha karakteristikat e gjuhëve specifike që janë të përbashkëta për nga cilësitë në të gjitha gjuhët e ndryshme: shqipe, gjermane, frënge... Në fund të kursit, studenti do të jetë i aftë jo vetëm të dallojë tiparet dalluese të gjuhëve specifike në aspektin leksikor, gramatikor e tekstor, por do të ushtrohet edhe në praktikën e evidentimit të tipareve dalluese të këtyre gjuhëve në gjermanishte dhe shqipe.

TESTIMI DHE VLERËSIMI PËR GJUHËN B (1)

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Jonida Bushi

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik / Semestri kur zhvillohet: 2021-2022/ Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: jonida.bushi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kursi synon aftësimin e studentëve në përvetësimin e metodologjisë së vlerësimit, në mënyrë që këta të fundit ta shohin atë si motivues dhe jo si ndëshkues, që vlerësimi të jetë i besueshëm dhe transparent, me kritere dhe objektiva të përcaktuara qartë.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- T'u jepen studentëve njohuritë themelore lidhur me vlerësimin dhe testimin e njohurive të gjuhës së huaj sipas niveleve.
- Ti njohë ata me objektivat e përgjithshëm dhe specifikë si dhe marrëdhëniet objektiv-vlerësim.

- Ti njohë ata me funksionet e vlerësimit.
- T'u aftësojë kompetencën e arsytimit, argumentimit dhe sistemimit të njohurive si nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve ashtu edhe nëpërmjet diskutimeve dhe paraqitjes së punimeve dhe projekteve përgjatë kursit.
- Ti aftësojë për të ushtruar një mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ në interpretimin e materialeve të ndryshme dhe në vlerësimin e njohurive të nxënësve në gjuhën e huaj.
- Ti aftësojë për të konceptuar dhe hartuar teste.

Objektivat specifike lëndore:

Në përfundim të kësaj lënde studenti duhet:

- të zotërojë njohuritë për matjen dhe vlerësimin
- të zotërojë aftësinë për të përzgjedhur instrumentet e matjes dhe të vlerësimit
- të përgatisë një vlerësim motivues me kritere dhe objektiva të përcaktuar qartë si dhe mundësisht me parametra matës.
- të zotërojë aftësinë për të përpiluar vetë teste bashkëkohore, në përputhje me objektivat dhe nivelin gjuhësor.
- të zotërojë aftësinë për të administruar dhe analizuar testet
- të zotërojë aftësinë për të vlerësuar në mënyrë profesionale
- të zotërojë aftësinë për të interpretuar vlerësimet për nxënësit
- të zotërojë aftësinë për të regjistruar rezultatet e nxënësve
- të zotërojë aftësinë për të kryer raportimin e vlerësimeve
- të jetë i orientuar për t'u përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të vetëvlerësimit
- të demonstrojë qëndrimin e duhur profesional sipas problemeve të vlerësimit
- të njohë dhe të përdorë sipas çështjeve literaturën e rekomanduar

METODOLOGJI E KËRKIMIT SHKENCOR

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Migena Sejdini

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 orë leksione / 30 orë seminare;

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

migena.sejdini@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs i njeh studentët me metodat e punës kërkimore të përdorura në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe në mënyrë të veçantë në kërkimet në gjuhën e huaj duke i pajisur ata me njohuri teorike dhe shprehje praktike për metodat e kërkimit, hartimit dhe përpilimit të një punimi shkencor. Në të trajtohen konceptualizimi dhe kryerja e kërkimit shkencor, parashtrimi i çështjeve të kërkimit, grumbullimi dhe mbledhja e të dhënave, përpunimin dhe analizimi i tyre si dhe shkrimi dhe raportimi i kërkimeve shkencore.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs i njeh studentët me ndryshimet midis kërkimit sasior dhe cilësor, me rolin e kërkuesit, me supozimet e tij për realitetin duke vënë theksin në kërkimet në vendin e punës, në përdorimin e metodave të ndryshme si dhe në procesin e përpilimit dhe shkrimit të punimit dhe përgatitjes së tij për botim. Synimi i këtij kursi është t'i aftësojë studentët për të lexuar dhe analizuar në mënyrë kritike kërkimet shkencore të botuara në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe mësimdhënies, për të kuptuar fazat e ndryshme të procesit të kryerjes së kërkimit shkencor, për të kuptuar mënyrat e ndryshme si mblidhen, përkruhen dhe analizohen të dhënat, për të shkruar një punim shkencor duke përdorur metodat sasiore dhe cilësore, për të shkruar punime shkencore, për të dalluar dhe përdorur stilin shkencor, për të cituar dhe për ta përdorur mendimin e huaj në përputhje me rregullat etike të studimeve shkencore.

Hartim i punimit shkencor

Titullari / pedagogu i lëndës: Kadzadej, Brikena, Prof. dr.

Ngarkesa: Kredite 6, 15 leksione-45 seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: 2021-2022, semestri III

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Mësuesi AML për Gjuhën Gjermane

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës:

brikena.kadzadej@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore:

Kjo lëndë ka si qëllim orientimin praktik me problematikat përkatëse në përpilimin e punimit shkencor të masterit.

Objektivat specifikë lëndorë: Ky kurs ka si objektiv trajtimin në vija të përgjithshme teorike , duke u përqendruar në mënyrë të detajuar dhe hap pas hapi me procedurat për hartimin e punimit shkencor (koncepti i punimit shkencor, përzgjedhja e temës, kriteret formale, përmbajtësore të punimit shkencor,udhëheqësi, forma, citimi etj.)

Në fund të këtij kursi kandidati për titullin Master do të jetë i aftë që bazuar në këto njohuri dhe praktikë jo vetëm të kuptojë kontekstet shkencore, por edhe t'i citojë ato siç duhet.